

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Thirri njerëz të armatosur", Luan Muça reagon për përplasjen me Vasil Bedinajn: Nuk më ftoi për sqarim, por për të prodhuar skandal - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/thirri-njerez-te-armatosur-luan-muca-reagon-per-perplasjen-me-vasil-bedinajn-nuk-me-ftoi-per-sqarim-por-per-te-prodhuar-skandal/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 17:24:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 17:19:11 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	525e36fc01f063b31e82e85695929e25c16ac6d1ebdf6cf665588f5bd73eebdc
TEKSTI	e36972c0281eff7e6f8fc50b8407e243a5d7396d0c21b4d74a6d3a69837e68ca
PAMJA	1ca753b50eda48ce2d2909d34686f43aeb7c22237f906e4125814ae691548f93

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	05437f700292d83f312a99b95c7fb3f8cc1052b21bbfd1cbd80c8cbc7f89c0d5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1c434e61d562588300a542a1a1eea29f4f74f5ffb0270b30e2f0091e2c10bb57
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.


<https://scan.stamles.eu/verify/05437f700292d83f312a99b95c7fb3f8cc1052b21bbfd1cbd80c8cbc7f89c0d5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

[Close Menu](#)

 [Informohu siç duhet](#)

Lajmet e fundit

[Skandal në derbin serb, tifozët nderojnë Ratko Milladin me një minutë heshtje](#)

[20 vatra zjarri në 24 orë, 11 aktive/ Ministria e Mbrojtjes publikon bilancin e situatës](#)

[Zjarr i ri në masivin pyjor të Tërbunit në Pukë, dyshohet për zjarrvënie të qëllimshme](#)

[Facebook](#) [X \(Twitter\)](#) [Instagram](#)

 [Informohu siç duhet](#)

- [Aktualitet](#)
 - [Aktualitet](#)
 - [Politike](#)
 - [Ekonomi](#)
 - [Sociale](#)
 - [Fokus](#)
- [Opinion](#)
- [Lifestyle](#)
 - [Showbiz](#)
 - [Udhetim & Turizëm](#)
 - [Kulturë](#)
 - [Shëndet](#)
 - [Horoskopi](#)
 - [Dekor](#)
 - [Trende](#)
 - [Teknologji](#)
- [Botë](#)
 - [Kosovë](#)
 - [Rajon](#)
 - [Botë](#)
- [Sport](#)
- [Troç](#)

[Youtube](#)

 [Informohu siç duhet](#)

You are at: [Home](#) » [“Thirri njerëz të armatosur”, Luan Muça reagon për përplasjen me Vasil Bedinajn: Nuk më ftoi për sqarim, por për të prodhuar skandal](#)

[AKTUALITET](#)

“Thirri njerëz të armatosur”, Luan Muça reagon për përplasjen me Vasil Bedinajn: Nuk më ftoi për sqarim, por për të prodhuar skandal

SEPTEMBER 6, 2026



Biznesmeni Luan Muça ka reaguar publikisht lidhur me përplasjen me biznesmenin Vasil Bedinaj, duke dhënë versionin e tij për ngjarjen dhe duke kërkuar nga Policia e Shtetit zbardhjen e plotë të saj.

Muça thotë se ka zgjedhur të heshtë deri tani për shkak të pozitës që ka mbajtur, por sipas tij, tashmë është e nevojshme që opinioni publik të dëgjojë drejtpërdrejt versionin e tij.

Sipas Muçës, ai ka investuar që prej vitit 2019 në zonën e Palasës, ku pretendon se ka blerë rreth 97 mijë metra katrorë tokë nga pronarë vendas. Ai deklaron se më 15 korrik 2021 ka marrë statusin e investitorit strategjik, mbi bazën e një projekti të hartuar nga studioja ndërkombëtare EEA – Emre Arolat Architecture.

Muça thotë se në vitin 2022 aplikoi për lejen e fazës së parë të ndërtimit të një hoteli me pesë yje dhe brand ndërkombëtar, ndërsa në vitin 2024 leja u zbardh dhe nisën punimet. Po gjatë vitit 2024, sipas tij, u bë edhe aplikimi për fazën e dytë të projektit.

“Që prej vitit 2019, kam vendosur të ndërmarr një investim në zonën e Palasës. Gjatë kësaj kohe, kam blerë në Palasë, nga shumë pronarë vendas, 97.000 m² tokë. Jam detyruar që, gjatë kësaj periudhe, pjesën më të madhe të tokës ta blej edhe nga dy herë”, deklaroi Muça.

Sipas tij, më vonë ka konstatuar përmes rrjeteve sociale se ishte dhënë një leje ndërtimi në tokën që ai pretendon se kishte blerë dhe mbi të cilën ishte dhënë statusi i investitorit strategjik. Ai thotë se në kuadër të projektit po reklamohej edhe shitja e njërive, apartamenteve dhe vilave.

Pas kësaj, Muça deklaroi se iu drejtua Agjencisë së Zhvillimit të Territorit për të marrë informacion mbi çështjen. Sipas tij, nga AZHT-ja u njoftua se dokumentacioni i palëve do të verifikohet dhe se deri në përfundimin e procesit nuk do të bëhej zbardhja e lejes së ndërtimit.

Muça pretendon se rreth një orë më vonë është telefonuar nga Vasil Bedinaj, i cili, sipas tij, i kërkoi të mos paraqiste në AZHT pretendimet lidhur me pronën. Të dy, sipas Muçës, ranë dakord të takoheshin në Orikum, në hotelin e Bedinajt, për të diskutuar situatën.

Biznesmeni pretendon se edhe në një takim të mëparshëm me Bedinajn, rreth një vit më parë, ky i fundit ishte shoqëruar nga disa persona të armatosur.

“Kur shkova atje, z. Bedinaj nuk ishte vetëm, por ishte i shoqëruar nga një numër i madh njerëzish të armatosur”, tha Muça.

Sipas versionit të tij, në takimin në Orikum, ai shkoi i shoqëruar nga familjarë. Muça pretendon se sapo nisi të shpjegonte pretendimet e tij lidhur me pronën, situata u tensionua dhe Bedinaj nisi ta shante dhe ofendonte.

“Edhe pse nga kamerat që z. Bedinaj i ka servirur opinionit publik kjo nuk duket qartë, në këtë moment ai thirri njerëz të armatosur, të cilët ishin të pozicionuar në vende të ndryshme të ambienteve të tij”, deklaroi Muça.

Ai pretendon se, pasi situata u përshkallëzua, vendosi të largohej nga ambientet e biznesit.

“Në këtë moment, situata ka degraduar dhe unë kam kuptuar se z. Bedinaj nuk më kishte thirrur për t’u sqaruar, por për të prodhuar skandalin e tij të radhës. Për këtë arsye, jam ngritur dhe kam ikur”, u shpreh ai.

Muça pretendon më tej se, gjatë largimit nga ambientet, ndaj grupit me të cilin ndodhej janë qëlluar me armë. Për këtë arsye, ai i ka kërkuar Policisë së Shtetit zbardhjen e plotë të ngjarjes dhe identifikimin e personave që, sipas tij, kanë qëlluar me armë.

Biznesmeni ka akuzuar gjithashtu Bedinajn për manipulim të opinionit publik, duke pretenduar se në media janë publikuar versione sipas të cilave ai i kishte vendosur gjobë.

“Jam çuditur shumë që, gjatë kësaj situatë, z. Bedinaj kishte qetësinë dhe përkujdesjen që, në të gjitha mediat mbi të cilat kishte ndikim, të shpërndante lajme të rreme, sipas të cilave unë i kisha vendosur gjobë, si dhe të shpërndante pamjet filmike nga këndet që ai dëshironte”, tha Muça.

Ai ka kundërshtuar gjithashtu akuzën për gjobëvënie, duke e cilësuar atë si një pretendim dashakeqës dhe duke vënë në dukje aktivitetin e tij biznesor në Shqipëri dhe jashtë vendit.

Muça deklaroi se është krijuar dhe zhvillues i një grupi kompanish që operojnë në katër kontinente dhe se bizneset e tij kanë qarkullim multimilionësh.

Ai pretendon gjithashtu se është mbajtur i ndaluar për 72 orë nga Policia e Shtetit nën dyshimin për gjobëvënie ndaj Vasil Bedinajt.

Në përfundim, Luan Muça është shprehur i gatshëm të vërë në dispozicion të mediave dhe opinionit publik dokumentet që, sipas tij, mbështesin deklaratat e bëra në reagimin e tij.

Pretendimet e bëra nga Muça janë versioni i tij për ngjarjen dhe pritet të përballen me provat e hetimit, si dhe me versionin e palës tjetër.

Share. [Facebook](#) [WhatsApp](#)
 Demo

Postimet e reja

[Skandal në derbin serb, tifozët nderojnë Ratko Mladicin me një minutë heshtje](#)

SEPTEMBER 6, 2026

[20 vatra zjarri në 24 orë, 11 aktive/ Ministria e Mbrojtjes publikon bilancin e situatës](#)

SEPTEMBER 6, 2026

[Zjarr i ri në masivin pyjor të Tërbunit në Pukë, dyshohet për zjarrvënie të qëllimshme](#)

SEPTEMBER 6, 2026

[Zbulohet fragment i “Iliadës” brenda një mumjeje egjiptiane të periudhës romake](#)

SEPTEMBER 6, 2026

Mos e humb

FOKUS SEPTEMBER 2, 2026

[6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe “problematikët”](#)

Miliona euro nga fondet publike për kompani që, sipas verifikimeve paraprake, nuk duket se kanë...

[Beralb fitoi 15 mln euro nga bakri shqiptar, por po helmon fshatra të tërë me ndotje](#)

[LISTAT E DELINËS/ Granti për startup-et riciklon fituesit, 15 emra morën para edhe në vitin 2025](#)

[Mashttrim, kredi grabitqare dhe praktika kriminale të huadhënies: Jo vetëm në Shqipëri, Kredo probleme edhe në vendin mëmë](#)

Na ndiq

- [Facebook](#)
- [Instagram](#)
- [YouTube](#)
- [TikTok](#)

RRETH NESH

 RRETH NESH

Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A
Email: radarlajme@gmail.com
Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

[Pak dramë, shumë ndjenja: Horoskopi i dashurisë për këtë javë](#)

[Kujdes me një dashuri të vjetër dhe me shpenzimet! Çfarë thotë horoskopi për sot](#)

[Vijnë mundësi të reja për të gjitha shenjat e zodiakut, çfarë kanë parashikuar vjet sot](#)

 Aleanca Elike e Medias
© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Type above and press *Enter* to search. Press *Esc* to cancel.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.